

AKT THEMELIMI
i Shoqërisë "DUAOPTIK" Sh.p.k.

Sot, më datë 13/03/2023,

- **Z. Elton Ferko**, shtetas shqiptar, lindur me 24/04/1981, në Tiranë, banues në Rrugën "Dalip Topi", Tiranë, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. personal I10424165W, madhor e me zotesi të plotë juridike e për të vepruar;

- **Zj. Merjem Bushati**, shtetase shqiptare, lindur me 10/08/1981, në Shkodër, banuese në Rrugën "5 Maji", "Concord Center", Tiranë, mbajtëse e dokumentit kartë identiteti me nr. personal I15810152M, madhore e me zotesi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "DUAOPTIK" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "DUAOPTIK" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njësi me nr. pasurie 6/488+2-N7, ndodhur në Rrugën "Komuna e Parisit", Zona Kadastrale 8270, Tiranë.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Shitje, blerje, aksesore optike;
- Vizita okulistike;

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektivit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike



shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakëve themelues në vlerën 100,000 Lekë (njëqind mijë lekë) dhe është i përbërë nga dy kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Elton Ferko**, zotëron 1 kuotë, me 49% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 49,000 Lekë (dyzetë e nëntë mijë lekë) dhe 49,000 Lekë (dyzetë e nëntë mijë lekë) të kapitalit themeltar.
- **Zj. Merjem Bushati**, zotëron 1 kuotë, me 51% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 51,000 Lekë (pesëdhjetë e një mijë lekë) dhe 51,000 Lekë (pesëdhjetë e një mijë lekë) të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

Zj. Merjem Bushati, shtetase shqiptare, lindur më 10/08/1981, në Shkodër, banuese në Rrugën "5 Maji", "Concord Center", Tiranë, mbajtëse e dokumentit Kartë Identiteti me nr. Personal I15810152M, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administratore për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë, duke autorizuar **Administratoren Zj. Merjem Bushati** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES

ELTON FERKO



MERJEM BUSHATI

